

Zymer (Ali) Buzhala-Kepa

(22.05.1940, shqiptar nga Budakova/Budakovo, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor ndërtimor, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Murat (Kurtish) Kokollari

(2.02.1943, shqiptar nga Budakova/Budakovo, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Zymeri e mbante rojën pranë spitalit të UÇK-së në *Mëhallën Buzhala*, ndërkaq Murati ishte në pozicionin e vet në *Mëhallën e Kepëve*, kur forcat serbe kanë hyrë më **29.09.1998** në Budakovë/Budakovo. Zymeri ka pësuar në afërsi të spitalit, ndërkaq Murati në *Mëhallën e Kepëve* [Budakovë/Budakovo]. Kur forcat serbe u tërhoqën më 30.09.1998, ushtarë të UÇK-së dhe banorë i varrosën Muratin dhe Zymerin në afërsi të *Varrit të Zenun Kepes*.

Burimet: deklarata A.B, FDH-32529; deklarata A.K, FDH-11167; deklarata N.N, FDH-3654; deklarata N.N, FDH-3655; deklarata N.N, FDH-3656; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; fotografi, FDH-19086.

Bajram (Dervish) Bytyqi

(1970, shqiptar nga Mushitishiti/Mušutište, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor, tre fëmijë)

Bajrami me familje e kanë braktisur Mushitishitin/Mušutište më 28.09.1998, kur kanë vërejtur se forcat serbe filluan të pozicionoheshin në fshat. U strehuan në pyllin e afërt. Në datën **29.09.1998**, kur situata u qetësua, ata vendosën të ktheheshin në shtëpi. Me ta u nisën edhe komshiu Bedri me të ëmën. Te *Ura e Dollocit/Dolovački most*, ata u ndalën nga policia serbe [identiteti i njërit nga policët është i njohur për FDH]. U urdhëruan Bajramit dhe Bedriut që të ndaheshin nga familjarët. Bajramit i thanë ta linte fëmijën, të cilin e mbante të shtrënguar ngrykë. Pastaj, familjarëve tjetër dhe nënës së Bedriut u urdhëruan që të largoheshin. I kanë rrahur Bajramin dhe Bedriun për gjysmë ore, duke i pyetur për UÇK-në. Pastaj, njëri nga ata që i rrihte, e mori me telefon urdhrin që t'i vrisnin Bajramin dhe Bedriun. Tre policë i morën Bajramin

dhe Bedriun dhe u nisën me ta drejt **Mushitishit/Mušutište**. Në afërsi të shtëpisë së Bedriut, u urdhëruan Bajramit dhe Bedriut të iknin me vrap. Kur Bajrami dhe Bedriu u larguan pak, policët shtënë ndaj tyre. Bajramin e qëlluan për vdekje dhe ai ra në tokë. Edhe pse i plagosur rëndë, Bedriu ia doli që të artisej. Dy ditë më vonë, trupin e Bajramit e ka gjetur Hatim Salihu. Bajramin e kanë varrosur më 2.10.1998 në varrezat e Mushitishit/Mušutište.

Burimet: deklarata B.H, FDH-11205; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00701, FDH-35931.

Sherif (Hasan) Buzhala

(7.04.1940, shqiptar nga Budakova/Budakovo, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor, katër fëmijë)

Sherifi me familje u larguan nga Budakova/Budakovo më 27.09.1998, kur forcat serbe e sulmuan fshatin. Qëndronin të fshehur në pyjet përreth, ndërkaq katër ditë rresht i kanë kaluar te një mik në Suharekë/Suva Reka. Më 03.10.1999 u kthyen në shtëpi. Në datën **9.10.1998**, Sherifi me tre miq u nisën në shtabin e UÇK-së, në vizitë te djali Nexhati. Te vendi i quajtur *Rrusha i Drurit*, në afërsi të **Budakovës/Budakovo**, kanë hasur në forcat serbe. Që të gjithë ia dhanë vrapit, por pjesëtarë të forcave serbe hapën zjarr ndaj tyre. Sherifin e kanë qëlluar për vdekje. Dy nga miqtë kanë arritur që të arratiseshin, ndërkaq të tretin e kanë zënë. Ditën e nesërme, ushtarë të UÇK-së e kanë gjetur trupin e Sherifit dhe e kanë bartur deri te familja. Në orët e mbrëmjes të së njëjtës ditë, Sherifin e kanë varrosur në varrezat e *Mëhallës Buzhala*.

Burimet: J. Osmani, *Krimet...*, I, 344; deklarata S.B, FDH-11176; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838.

Dejan (Milorad) Arizanović

(6.05.1978, serb nga Surdullica, elektroteknik, i pamartuar, pjesëtar i UJ-së)

Në datën 18.03.1998, Dejan i ka shkuar në kryerjen e shërbimit të rregullt ushtarak në Gjakovë/Đakovica. Me qëllim që të ishte sa më afër të birit, babai i tij u punësua në